



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:115437

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05567216

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku dhe bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi në çështjen penale ndaj të pandehurit S.B., me vendbanim në Rr. "...", nr...., komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 04/1-082 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.768-13/2019 të datës 15.09.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më 09.02.2024, në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri S.B. me mbrojtësin e tij me autorizim av. Urim Pozhegu dhe të dëmtuarit: R.H., I.L. me përfaqësuesin e tij me autorizim Admir Salihu, më datë 12.02.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 12.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.B. nga i ati B., e ëma D. e gjinisë G., i lindur me datë ... në fsh. ... K. Gjakovë, me vendbanim në – Zvicër dhe me adresë banimi në Rr. "..." nr.... K. Gjakovë, me numër personal, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-së:

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Në vazhdimësi gjatë vitit 2014, në bashkëkryerje me të pandehurit B.B. dhe Zh.B., të cilët gjenden në arrati, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vetën, me anë të paraqitjes së rreme si pronarë të kompanisë për përpunimin e metalit “B.AG”, me seli në Cyrih Zvicër, e cila nuk ekziston më që nga viti 19.12.2012, me dashje kanë sjellë në lajthim tani të dëmtuarit I.L., pronar i kompanisë SHPK “M.L.” me nr. biznesit në Ferizaj, F.B. pronar i kompanisë NPT “B..M.” në Pejë, dhe R.H. pronar i NPT “L.G.” me nr. biznesit ... në Rahovec, duke i nxitur që të kryejnë veprime në dëm të pasurisë së tyre, në atë mënyrë që pasi kishin lidhur marrëveshje joformale, të dëmtuarit kishin përpunuar matëriale prej metalit dhe xhamit sipas porosisë për të importuar në Zvicër, me ç’ rast të pandehurit nuk ju kanë përgjigjur kompanive vendore dhe nuk i kanë kryer obligimet financiare, duke i shkaktuar dëm në vlerë të përgjithshme prej 87,583.09 €.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale në bashkëkryerje **Mashtrimi** nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

- Të dëmtuarit I.L. dhe R.H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest juridiko-civil.

- I dëmtuari F.B. nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.768-13/2019 të datës 15.09.2020, ndaj të akuzuarit S.B., me vendbanim në Rr. “...”, nr...., K. Gjakovë, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, i hapur për publikun, i cili është mbajtur më 09.02.2024, në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, prokuror në

Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri S.B. me mbrojtësin e tij me autorizim av. Urim Pozhegu dhe të dëmtuarit: R.H., I.L. me përfaqësuesin e tij me autorizim Admir Salihu.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: duke u bazuar në provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor me pa mëdyshje është vërtetuar se i pandehuri me veprimet e tij, duke vepruar edhe në bashkëkryerje me vëllain e tij dhe babain e tij kanë vënë në lajthim të dëmtuarit përmes paraqitjes së fakteve të rreme dhe i kanë shtytë që të vepronë në dëm të pasurisë së tyre me çka edhe ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve respektivisht të dëmtuarve I.L., F.B. dhe R.H.. I pandehuri në këtë rast për ti vënë në lajthim të dëmtuarit kishte angazhuar vëllain e tij Zh.B. që i njëjti të vij në Kosovë dhe të bisedoj me të dëmtuarit dhe të merret vesh për kryerjen e punëve të materialit nga metalet dhe qelqi duke ju prezantuar edhe para masat të sjella nga shteti i Zvicrës dhe duke ju prezantuar të dëmtuarve si përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë “B.AG.” me seli në Zvicër. Të dëmtuarit kishin besuar te ky i fundit duke menduar që e gjithë kjo është një punë e vërtetë dhe me qëllim të operimit të tyre si biznese dhe për ta treguar respektivisht dëshmuar punën e tyre edhe jashtë Kosovës kishin hyrë në raporte kontraktore, kishin filluar këmbimin e materialeve duke dërguar materialet e punuara dhe të porositura nga firma “B.AG.” të cilat me dijeninë e të pandehurit ishin transportuar për në shtetin e Zvicrës dhe atë në disa njësi transprorutese dhe përfundimisht në momentin kur materialet e punuara nga të dëmtuarit kishin arritur vlerën e rreth 90 mijë euro si obligim pa paguar nga firma “B.AG.” pronë e të pandehurit S.B., i pandehuri për të ju shmangur këtij obligimi dhe për të ja pamundësuar ekzekutimin e kërkesës të dëmtuarve i njëjti shkëput çdo kontakt me të dëmtuarit dhe fare nuk ju përgjigjet të njëjtëve duke i lajthitur edhe në mënyra tjera kinse materiali i dërguar për kompaninë e tij ishte me defekte e po ashtu shpeshherë edhe duke u arsyetuar kinse në vonesa të pa qenë në këtë rast. Për të sqaruar për këto rrethana i dëmtuari I.L. gjatë marsit të vitit 2015 merr rrugën dhe nis për në shtetin e Zvicrës, saktësisht për në adresën që i kishte dhënë i pandehuri përmes vëllait të tij Zh.B. të kompanisë “B.AG.” dhe kur kishte shkuar ky i dëmtuar në atë adresë aty kishte kuptuar se kjo kompani që nga viti 2012 nuk ekziston më në atë adresë dhe në vendin në fjalë ishte vetëm një kuti postare e vendosur në adresën e biznesit tjetër dhe nuk ishte asnjë njoftim apo udhëzues se ku ndodhej kompania “B.AG.”. I dëmtuari ishte munduar që edhe përmes telefonit të kontaktoj vëllain e të pandehurit Zh.B. por që asnjëherë nuk kishte arritur që ta merr të njëjtin në kontakt për shkak se numri që i kishte dhënë të

dëmtuarit ai numër më nuk ekzistonte. Çështjet e pretenduara nga mbrojtja e të pandehurit se kinse falimentimi i kompanisë “B.AG.” ka ndodhur për fajin e të dëmtuarve e posaçërisht për fajin e të dëmtuarit I.L., ky pretendim nuk është i bazuar në asnjë provë konkrete pasi që po ti referohemi dëshmime të siguruara përmes rrugëve diplomatike nga shteti i Zvicrës është vërtetuar fakti se deklarimi i falimentimit të kompanisë “B.AG.” është bërë në vitin 2016 dhe si procedurë ka përfunduar në vitin 2018, kurse në anën tjetër të gjitha transaksionet që janë bërë në mes të pandehurit dhe të dëmtuarve janë bërë në vitin 2014, konkretisht deri në muajin e fundit të këtij viti. Po të kishte qenë kjo e vërtetë i pandehuri me siguri qysh në atë kohë gjatë vitit 2015 do të kishte filluar procedurë në shtetin e Kosovës për ta zgjidhur atë problem e jo të ju shmanget si të dëmtuarve ashtu edhe organeve të drejtësisë. Po ashtu pretendimi se shkak i falimentimit janë defektet në materiale të dorëzuara nga kompania “M.L.” pronë e të dëmtuarit I.L., këto janë të pa mbështetura respektivisht të pa argumentuara me ndonjë provë konkrete pasi që po të shihen me shumë kujdes fotot e prezantuara nga vet mbrojtja mund të arrihet në një përfundim edhe nga një vëzhgues i thjeshtë dhe objektiv se këto defekte më shumë i atribuohen defekteve në montim sesa defekteve në prodhim apo edhe mund të këtë qenë ndonjë ngatërresë kur janë vënë para masat të cilat i ka prezantuar të dëmtuarve vëllai i të pandehurit S.B. në këtë rast Zh.B.. Po ashtu një fakt për të besuar se i pandehuri në mbrojtjen e tij mundohet që ti shmanget përgjegjësisë penale për veprën e cila i vihet në barrë, mjafton vetëm të analizohet me vëmendje mbrojtja e tij e dhënë gjatë fazës së hetimeve dhe ajo e dhënë në gjykatë ku i njëjti bie në kundërshtim në disa rrethana me vetveten ku posaçërisht me mbrojtjen e tij mundohet që rolin e të pandehurit Zh.B. për të cilin kanë filluar hetimet, të njëjtin rol ta relativizoj duke i dhënë një pozitive të parëndësishme e herë duke e trajtuar si person me pozitive shumë të rëndësishme në atë kohë në kompaninë “B.AG.” .

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë dhe duke i marrë për bazë edhe provat tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor me pa mëdyshje është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me neni 31 të KPRK-së, andaj edhe i propozoj gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ndaj tij duke marrë për bazë rrethanat të cilat ndikojnë në matjen e dënimit të parapara me nenin 73 dhe 74 të Kodit Penal në këtë rast si rrethana renduese shkalla e lartë e dashjes së të pandehurit për ta kryer veprën penale, fakti që vepra penale është kryer në bashkëkryerje kurse sa i përket rrethanave lehtësueses përveç sjelljes korrekte që i pandehuri ka pasur ndaj gjykatës nuk është gjetur rrethanë tjetër, andaj edhe mbi këtë bazë gjykata të pandehurit ti shqiptoj një dënim që është i paraparë me ligj e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit e veçanërisht me atë dënim të ndikohet tek i

pandehuri që në të ardhmen të risocializohet dhe mos të përsërisë veprime të tilla dhe po ashtu si dënim plotësues ndaj të pandehurit gjykata të shqiptoj edhe urdhrin për kompensimin e humbjes apo dëmit ndaj të dëmtuarve I.L., F.B. dhe R.H..

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar I.L., av. Admir Salihu në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesim në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit edhe pse i njëjti e ka marre me vonese këtë lëndë nga fjala përfundimtare shihet qartë se në tërësi i ka analizuar të gjitha veprimet në dobi të palës së dëmtuar duke ma lënë mua të pamundur të them ndonjë fjalë tjetër. Deri tek zbulimi i këtij mashtrimi kemi ardhur krejt rastësisht kur I.L. ka dërguar produkte të hekurit për zinkim dhe personi që e kryen zinkimin e ka informuar I.L. se kush i ka porositur këto meqë janë të njohura për të me te cilën më pas e ka vënë në kontakt me F.B. bashkërisht më pas e kanë kuptuar se bëhet fjalë për të njëjtin person i cili jo rastësisht ka zgjedhur vetëm Pejën, Ferizajn dhe Rahovecin për arsye që të pamundësohet këmbimi i informatave mes firmave me produkte të njëjta. Gjatë tërë gjykimit fillimisht i akuzuari në një moment e kishte mohuar se e ka vet vëlla Zh.B. duke e prezantuar vetën si punëtor, kurse arsyen pse gjatë tërë kohës e ka sulmuar I.L. është për faktin se borxhi ndaj I.L. është më i madh se ndaj të tjerëve, nëse i analizojmë shkresat e lëndës çdo komunikim që “B.AG.” ka kërkuar nga I.L. përgjigja e këtij të fundit ka qenë 1-2 ditë pas kësaj kërkesë ndërsa përgjigjet e “B.AG.” ndaj I.L. për produktet që vet i ka dërguar shpeshherë ka marrë kohë deri në 6 muaj. Gjatë kësaj procedure penale është mohuar në tërësi që këta kanë pasur një raport kontraktual ndonëse vet “B.AG.” në shkresat e lëndës ka fatura që ja ka paguar I.L. dhe cila do të ishte arsyeja apo logjika e pagesës së faturave për një kompani që nuk ke fare raport kontraktual, të gjitha pretendimet tjera të palës së akuzuar kanë qenë të paqëndrueshme dhe shmangie nga përgjegjësia për veprimet e tyre. Kërkesa pasurore juridike e I.L. është 60 mijë euro duke pasur parasysh se 9,000 euro nga këto janë para kesh që ja ka dhënë Zh.B. me idenë që i njëjti do të ja jep përmes pagesës me transaksion e që do të thotë kjo që përpos që e kanë mashtruar I.L. në aspektin kontraktual përmes faturave duke mos ja kryer obligimet të njëjtit i kanë marre edhe para kesh, mirëpo këto para janë dhënë në raport me Zh.B. ndërsa sa i përket S.B. kërkesa pasurore juridike është 59,782.09 euro në baze të faturave që gjenden në shkresat e lëndës.

I dëmtuari R.H. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Unë kërkoj nga S.B. që të ma kthej borxhin, ku para një viti unë kam biseduar me S.B. dhe i njëjti më ka premtuar që do të ma kthej borxhin në vlerën mbi 16 mijë euro dhe ndaj S. nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale vetëm kërkoj që të ma kthej borxhin pasi që arsyetimi i tij ka qenë udhëheqës i firmës vetëm

formalisht se nuk e di se çfarë kanë bërë babai me Zh., nga S.B. personalisht nuk ndjem i mashtruar por ndjem i mashtruar nga babai i tij B.B. dhe nga vëllai i tij Zh.B., dua të shtoj se parashtrroj kërkesë pasurore juridike, ne jemi marrë vesh me Samiun që ta bëjmë një marrëveshje me shkrim dhe i njëjti të më paguaj çdo muaj nga 2000 franga deri në pagesën definitive të borxhit mirëpo ende nuk e kemi lidhur këtë marrëveshje me shkrim dhe vetëm jam duke e pritur konfirmimin nga ana e tij pasi që unë jam i gatshëm për këtë marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Urim Pozhegu në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Në këtë çështje penale pas administrimit të provave materiale dhe personale, dëgjimit të dëmtuarve dhe dhënies se mbrojtjes nga i akuzuari ,konsiderojmë se prokuroria në tersi ka dështuar të argumentoj dhe te provoj aktakuzën lëndore për faktin se ne këtë qeshje penale nuk ekziston asnjëri nga elementet esenciale qe sajone figurën e veprës penale te mashtrimit nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, duke mos arritur për asnjë moment qe te vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si ne diapozitiv te aktakuzës ashtu qe me asnjë fakt apo prove te vetme nuk është arritur qe te vërtetohet përtej dyshimit te bazuar mire se S.B. ka kryer veprën penale te përshkruar ne aktakuza. Prokuroria ka dështuar te arsyetoj kërkesën e saj qe S.B. te shpallet fajtor për veprën penale për te cilën akuzohet, për shkak te ekzistimit te shkarjeve te mëdha logjike ne mes te pretendimeve nga një aktakuzë boshe dhe shume përfaqëso re pasi qe diapozitivi i aktakuzës nuk ka përshkruar e secilës pale te dyshuar qe është ne kundërshtim me dispozitat e KPRK-se, meqenëse çdo veprim i bash kryerjes duhet te përshkruhet ne mënyre qe te plotësohet elementet e figurës penale ne bash kryerje si rrjedhoje provat e administruara ne këtë qeshje penale nuk e kane fuqinë provuese për te vërtetuar faktin se i akuzuari ka ndërmarrë ndonjë veprim ne drejtim te kryerjes se veprës penale per te cilën akuzohet nga prokuroria. I.L. Pronar i “L.M.” ne mënyre kronologjike ka deklaruar se gjate muajit mars 2014(gjate kohës kur ”B.AG.” ka egzistuar dhe ka qen aktive si firme ne zvicer) nga një person i panjohur ka marre numrin kontaktues te personit Zh.B., se vet ka shkuar ne Zvicer eka takuar Zh.B. dhe se ne menyre te vazhdueshme ka komunikuar me Zh.B. e asesi me S.B. te cilin sipas deklarimit publik te tij para gjykatës eka pare për her te pare ne sallën e gjykatës, ka konfirmuar personalisht se ne vitin 2014 pas hulumtimit te ber ne internet qe firma “B.AG.” eshte firm aktive me aktivitet biznes or ne zvicer, se me “B.AG.” ka nënshkruar kontrate me date 24.09.2014 te cilën eka përcjell përmes e-mail zyrtare ne “B.AG.” , ka konfirmuar se gjate vitit 2014 ne llogarinë bankare te firmës i “L.M.” ne Ferizaj nga llogaria bankare e “B.AG.” jan kredituar pagesat prej 10,250.41-€ dhe 14,943.77-€ si kurse edhe pagesa cash ne shume prej 9,600.00-€. Me vet faktin e ekzistimit te pagesave te konfirmuara dhe formalisht përmes

transaksionit bankar te realizuara ne vitin 2014, bie poshtë pretendimi i prokurorisë se “B.AG.” është firmë jo aktive sepse një firmë e falimentuar (fantome) nuk mund te realizoj transaksione përmes llogaris bankare jo vetëm ne kosov por asnjë menyre edhe ne zvicer me çënsë llogarit e firmës te falimentuar gjithmonë janë te bllokuara dhe jo funksionale fakt ky notor dhe i pa kontestueshëm. Prodhimet e “L.M.” janë liferuar tek porositësi ”B.AG.” ne zvicer, por malli i cili është përcjelle ka pasur vonesa te konsiderueshme ne aspektin kohor, ky mellë ne përqindje te larte nuk ika plotësuar kriteret e përcaktuara me kontrat lidhur me kualitetin, se ka pasur te meta ne kundërshtim me plan-situacionet e dhëna nga porosia për te cilat sipas kontratës dhe marrëveshjeve jo formale ka pasur saksione te precizuara per te cilat “L.M.” eshte njoftuar me kohe dhe detalisht përmes e-maileve nga perosni përgjegjës i ”B.AG.”. Gjithashtu si pasoj e mosveprimit te firmës “L.M.” i akuzuari përmes provave matreiale te dorëzuar ne kete gjykatë ka dokumentuar se ka bere çmos për te mënjanuar një dem te madh ne firmën e tije dhe me ketë rast është detyruar qe me shpenzimet e firmës ”B.AG.” qe kane pasur një kosto shume te larte te bej riparimin e këtyre mallrave për te sjellur një pjesë te mallit ne funksion te bërjes se tyre te pranueshme për momentin dhe faktin se nj epjes e mallit gjate transportit qe ka qen barre e dërguesit është liferuar se i dëmtuar dhe me te meta te dukshme ne mase te konsiderueshme, fakte këto te cilat janë konstatuar përmes provave materiale-fotove nj epjes e cila ekziston ne shkresat e lendes. Kjo ka rezultuar ne nje përfundim aspak te drejt me qense ky mellë është ber shkas qe ndërmarrjes nënkontraktuese kompanisë ”B.AG.” me bashkëpronare S.B., ti shkëputet kontrata nga kontraktori “P.”, ne te njëjtën kohe i eshte shqiptuar gjoba ne shume prej 300.000-sfr (treqind mijë franga zviceriane),qe shpien kompaninë ”B.AG.” ne falimentim ne vitin 2018 dhe te njëjtës ti mbyllet aktiviteti i saj banesorë me një dem te përgjithshme prej 500.000-sfr (pesë qind mijë frnaga zviceriane).Mbi bazën e këtyre te dhënave Gjykata duhet qe me kujdes ti analizoj dhe te vlerësoj te gjitha këto argumente qe janë te faktuara ne shkresat e lendes me prova materiale konkrete e kredi bilë, te konstatoj raportet konkraturale dhe joformale te palëve ne periudhën para dhe gjatë viti 2014, janë te natyrës juridiko-civile e assesi te asaj natyre qe përmbajnë ndonjë element te veprës penale te mashtrimit ne menyre qe te nxjerre një vendim te drejt dhe te ligjshëm. Se deklarimi i I.L. eshte tërësisht subjektiv, mos përputhje te thella dhe nuk është i sinqertë ,por është kundërthënës dhe kondraktor e vërteton fakti se gjate procedurës penale fillimisht deklaroi se përgjegjësi i firmës “Z.U.” ka ardhur selinë ne firmën e tij “L.M.” ne Ferizaj qe te shoh materialet dhe se ky është momenti kur është pyetur nga përfaqësuesi i “Z.U.” se këto produkte “ *a janë për shtetin e Zvicrës duke paralajmëruar qe te ketë kujdes*” ndërsa ne pyetje e tërthorta deklaroi se “ *me përqaftuesin e “Z.U.” ky paralajmërim t’i ketë ndodhur ne momentin kur ika dërguar ne selin e*

“Z.U.” te calinë e konfirmon ne pyetjen pasuese te mbrojtjes si dhe ne pyetjen e Gjykatëse lidhur me fakt, andaj si mbrojte e konsiderojmë se deklarimit te tije kontradiktor dhe aspak bindëse gjykata nuk duhet te ja fal besimin. F.B. pronar i ”B..M.” ka konfirmuar se gjate vitit 2013 me ”B.AG.” be Zvicër (gjate kohës kur “B.AG” ka ekzistuar dhe ka qen aktive si firmë ne Zvicër), ka pasur bashkëpunim kontraktual përmes punës se vlefshme juridiko-civile dhe atë përmes kontratës formale, se ky bashkëpunim ka vazhduar edhe gjate vitit 2014, se per punët e kryera është kompensuar ne vazhdimësi përmes llogaris bankare , se ka qen viti 2014 kur edhe ka kuptuar se S.B. eshte njeri nder aksionaret e ”B.AG.” se ka pasur komunikime telefonike dhe se për here te pare te nijetin eka takuar ne gjykate, se per shkak te jo likuiditetit te ”B.AG.” ka pasur vonesa ne pagesat e shërbimeve e assesi mashtrim, se është likuiduar ne tersi për borgjin e mbetur me date 12.04.2021 dhe se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kerkes pasurore-juridike andaj këtij deklarimi gjykata duhet te ja fal besimin e plote. Ne deklarimin e R.H. pronar i “L.G.” i njëjti ne mes te tjerash ka konfirmuar se me firmën ”B.AG.” ka hyre ne marrëdhënie kontraktua le ne prill te vitit 2014 (gjate kohës kure “B.AG” ka ekzistuar dhe ka qene aktive si firme ne zvicer), se per punimet fillestare është paguar nga firma ”B.AG.”, se personin S.B. nuk e ka pasur te njohur dhe as qe ka biseduar ndonjëherë me te, se komunikimet me ”B.AG.” i ka pasur vetëm përmes Drejtorit te Financave te “L.G.” , se me S.B. është takuar për here te pare pranë kësaj gjykate dhe se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale qe nënkupton se i njëjti nuk ndihet i mashtruar por është i interesuar te arrije marrëveshje për përmbushjen e obligimit te mbetur te cilit deklarim gjykata duhet te ja fal besimin. Deklarimi i S.B. prej fillimit te procedurës para-penale ashtu edhe gjate rrjedhjes se procedurën penale pranë kësaj gjykate ka qen i sinqertë, koherent, detal ,konciz dhe plotësisht i argumentuar, duke i kontribuar zbardhjes se vërtetës me çense deklarata e tij kanë qen te pandryshuara qyshe nga faza e mëhershme e procedurës ne harmoni te plote me realitetin e ngjarjes se ndodhur, është logjik dhe i mbështetur ne provat materiale te pakontestueshme te deponuara nga mbrojta dhe ne faktet tjera duke vërtetuar kështu fakti se i njëjti nuk ka asnjë lloj lidhje me kryerjen e veprës penale siç padrejtësisht aludohet ne aktakuzën lëndore. S.B. me asnjë veprim nuk ka paraqitur as edhe një fakt te rrejtshëm se firma ”B.AG.” me seli ne Cyrih te Zvicrës nuk ekziston qe nga data 19.12.2012 por përkundrazi me prova matriale konkrete ka dokumentuar te kundërtën e asaj qe aludohet ne aktakuzën e ”B.AG.” ka qen firmë aktive e regjistruar deri ne falimentimin ne saje ne vitin 2018, nuk ka nxitur apo shtyre “te dëmtuarit” qe te kryejnë veprime ne dem te pasurisë se tyre dhe se cila marrëveshje formale apo verbale ka qen e lidhur ne mbështesje te parimit te ndërgjegjshme ris dhe mirëbesimit ne pajtueshmëri te plot mes palëve kontraktuese. S.B. si njeri nga aksionaret e firmës ”B.AG.” ka treguar se

kanë paturp raporte biznesore-kontraktuale me firma te ndryshme e nder to edhe me firmën “L.M.” , se ”B.AG.”,”B.M.” dhe “L.G.” se këto raporte kontraktuale me këto firma kan filluar ne vitin 2014 (gjate kohës kur “B.AG” ka egzistuar dhe ka qen firmë aktive ne zvicer), se ”B.AG.” ne cilësinë e kontraktuesit te firmës “P.” ne zvicer ka pranuar mellë, ka ber pagesa per at malle, se ka pasur vonesa ne liferim te mallit dhe mungesë te kualitetit nga dërguesit e mallit firma “L.M.” se ”B.AG.” e ka njoftuar te njëjtën zyrtarisht përmes e-mail bashke me foto dokumentacion dërguesin e mallit për vonesat dhe te metat , për riparimet e domosdoshme te mallit, demin e shkaktuar si dhe mundësin e penalizmit dhe humbjen e kontratës me kontraktuesin ”B.AG.” firmën “P.” të Zvicrës. Per te gjitha këto arsye ”B.AG.” e ka pasur te pa mundur likuiditetin e saj qe ka rezultuar me falimentimin e firmës ”B.AG.” gjate vitit 2018 me ç ‘rast ka pësuar edhe ndëshkimi i pritur ne shume prej 500.000 sfr, andaj gjykata këtij deklarimi duhet te ja fal besimin e plotë. Se prokuroria ka dështuar te provoj gjendjen faktike te përshkruar ne aktakuzën lëndore, ketë e dëshmon edhe fakti se pas pranimit te Raportit nga Departamenti Federal për Ekonomi, Arsim dhe Kërkim përkatësisht sekretariati shtetëror për qeshje ekonomike SECO nga shteti i Zvicrës, i cili raport është përpiluar pas kërkesës se prokurorisë dhe e siguruar përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtare, me te cilën është kërkuar verifikimi i gjendjes faktike sa i perkës statutit te firmës ”B.AG.” gjate periudhës se veprimtarisë se saj, kjo provë materiale ne tërësi vërteton ate te cilën e kemi theksuar dhe ne si mbrojtje qe nga procedura parapenale e ashtu si kurse edhe gjate këtij shqyrtimi gjygesor e te cilën e kemi mbështetur edhe me prova materiale te cilat veq e konfirmojnë atë çfare kemi thënë se kompania “B.AG.” është pas ardhëse e kompanisë “X.S.S.” e cila eshte themeluar me datë 11.12.2012, deklarimi i falimentimit është data 12.04.2018. Kjo prove e siguruar ne menyre te ligjshme përmes rrugëve institucionale dhe nen supozimin se mund te perbej inkriminimin te mundshëm, ne kuptim te nenit 215 par 6 te Kpp-së, nuk mund te jet baze e vetme dhe vendimtare per gjetjen e fajesis ndaj S.B.. Raporti nga Departamenti Federal për Ekonomi, arsim dhe Kërkim - SECO nga shteti i Zvicrës, është **prov** ne te cilën vet prokurori, përqaftuesi i te dëmtuarit I.L., F.B. dhe R.H. janë shprehur se nuk kane vërejte qe rrezon ne mënyre te pakundërshtueshme pretendimin e prokurosi për gjendjen faktike nga diapozitivi i aktakuzës se “kinse i bashkeakuzauri S.B. me ane te paraqitjes se rreme si pronare i kompanisë per përpunimin e metalit B.AG. me seli ne Cyrih te Zvicres e cila nuk eksiston qe nga data 19.12.2012 ka sjellur ne lajthim tani te dëmtuarit...” por qe vërteton faktin se S.B. bashk me S.B.1. eshte njeri nder bashke themeluesit e kompanisë “B.AG.” me seli ne Cyrih te Zvicrës dhe se kjo kompani para dhe pas kësaj date (19.12.2012) ka qen aktiv, ka zhvilluar aktivitetin e saj biznes or dhe ka pasur transaksione bankare legjitime brenda dhe jashtë Zvicrës pra edhe ne

vitin 2014, se për te njëjtën me date 25.05.2016 është deklaruar likuidimi, se me date 19.12.2017 është shpallur e falimentuar dhe se me date 09.04.2018 është fshire nga regjistri i bizneseve aktive ne Zvicër. Rikujtojmë gjykatës edhe një herr se prokuroria ne diapozitivin e aktakuzës ne njëren ane pretendon se “ me qellim te përfitimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore për veten , me ane te paraqitjes se rreme si pronare te kompanisë se përpunimit e metalit “B.AG.”, me seli ne Cyrih te Zvicrës e cila nuk ekziston me qe nga data 19.12.2012, me dashje kane sjell ne lajthim tani te dëmtuarit I.L. pronar i kompanisë SHPK “M.L.” me numër biznesi ... ne Ferizaj, F.B. pronar i kompanisë NPT” B.M.” ne Pejë, dhe R.H. pronar i NPT “ L.G.” me numër biznesi ... ne Rahovec, duke i nxitur qe te kryejnë veprime ne dem te pasurisë se tyre, ne atë mënyrë qe pasi kishin lidhur marrëveshje jo formale, te dëmtuarit kishin përpunuar materiale prej metalit dhe xhamit sipas porosis për te importuar ne Zvicër , me ç ‘rast te pandehurit nuk ikan përgjigjur kompanive vendore dhe nuk ikan kryer obligimet financiare, duke i shkaktuar dem ne vlerë te përgjithshme prej 87,583.09-€”. Për derisa ne anën tjetër ne shqyrtimin gjyqesore prokurori i çështjes bie ne kundërshtim te plote me vetveten atëherë kur parashtron pyetjen ndaj te akuzuarit citoj: **“si mund ta arsyetoni mos gadishmërinë e juaj per tu takuar pikërisht me datë 26.02.2015, ne te cilën kohe ju ende nuk kishit te hapur procedurën e falimentimit”**, që rrjedhimisht vërteton faktin se vet prokurori vërteton faktin se ”B.AG.” me datë 19.12.2012 paska qen firm aktive dhe paska ekzistuar si biznes i ligjshëm ne Zvicër e qe automatikisht rrëzon pretendimin nga diapozitivi i aktakuzës “ e cila nuk ekziston me qe nga 19.12.2012..” Te gjitha këto fakte vendimtare na shpien te konstatimi përfundimtar se ”B.AG.” si ndërmarrje e regjistruar dhe aktive ne Zvicër nga viti 2012 deri ne vitin 2018, ne raport me “L.M.” , “B.M.” dhe “L.G.” gjate kohës se bashkëpunimit kane krijuar raporte kontraktua le juridiko-civile (biznesore) ne mënyrë te ligjshme, duke i pasur te njohura paraprakisht te drejta dhe detyrimet e ndërsjella pa prezencën e lajthimit, mashtrimit apo çfarëdo elementi të veprës penale. Me paraqitjen e rrejshëm te fakteve nënkuptohet pohimi per ekzistimin e ndonjë fakti qe nuk egzistone, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo qe vërtet ekziston (ajo qe ekziston tregohet jo saktësisht).Fshehja e fakteve ekziston kur kryesi , ndonjë person e mashtron tjetrin për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtën e tyre , nëse ka ekzistuar detyrimi i tij qe ato fakte ti tregonte. Ndërkaq te tregimi i rrejshëm kryesi e bind ndonjë person për ekzistimin e ndonjë fakti qe nuk ekziston, domethënë te fshehja ai e pengon personin qe ti mësoj faktet qe vërtet ekzistojnë e te cilat janë relevante për pajisjen ne dispozicion te pasurisë se tije dhe pasurisë se huaj dhe te cilat do te zmbropsin nga pasojat e dëmshme ne raport me ketë pasuri. Këtu patjetër duhet te shqyrtohet çështja nëse midis

qëndrimin te ndërgjegjshëm te subjektit aktiv dhe demit te viktimës ka ose jo lidhje kauzale si dhe qka parashohin dispozitat e kontratës nëse ka konteste te mundshme mes palëve. Vet fakti qe me pasë vërtetohet se kontratat formale apo marrëveshje verbale kanë qene te lavër ditshme per secilën pale, nuk mund te shërbej si baze për te ven para përgjegjësia penale përsosnin qe ka përfituar nga lidhja e kësaj kontrate, ashtu siç nuk mund te themi apriori se ndodhemi para veprës penale te mashtrimit kur debitori nuk do te plotësonte detyrimin brenda afatit te përcaktuar ne kontrate, çfarë veprimesh te tjera ka kryer i akuzuari qe te përvetësoj. Kësisoj prokuroria përmes aktakuzës ka dëshmuar te vërtetoj se ne veprimet e te pandehurit ka elemente qe tregojnë se i njëjti ka mashtruar apo ka vene ne lajthitje te dëmtuarit e pretenduar, duke mos arritur te vërtetojnë qëllimin dhe dashjen e te njëjtit ne përvetësimin e shumes se përcaktuar si ne diapozitivi i saj ka ngelur i mangët e kontradiktor me vetveten pasi qe prokuroria ne një rën an aludon se gjate vitit 2012 firma “B.AG.” nuk ka ekzistuar e ne anën tjetër nuk mterhiqet nga ndjekja penale edhe pse tashme është e bindur dhe vërtetuar me prova konkrete se gjatë vitit 2012 e tutje kjo firmë ka ekzistuar, ka qen aktiv, tërësisht e ligjshme dhe legale me aktivitet dhe veprimtari ne shtetin e Zvicër. Standardi i te provuarit sipas KPP-së edhe pse nuk është përcaktuar ne mënyre eksplicite , ndërsa nëse i referohemi dispozitës te nenit 3 paragrafi 2, ”se mëdyshjet e ekzistimit te fakteve te rëndësishme për çështjen interpretohen ne favor te pandehurit” , andaj ne interpretimin **a contrario** nënkupton se faktet inkriminuese duhet te vërtetohen prej dyshimit te arsyeshme. Në këtë çështje penale nuk janë formësuar elementet e përgjithshme te veprës penale te cilat duhet te përmbushen ne mënyrë kualitative, pasi qe mungon motivi dhe qëllimi i te mbrojturit tim per te kryer vepër penale, ngase nderlikushmeria e natyrës se figurës se veprës penale inkuadron ne vet mënyra te ndryshme me te cilat kryhet kjo vepër penale e qe ne rastin konkret , mungojnë tërësisht. Rikujtojmë se sipas nenit 47 të KPP-së, prokurori i shtetit ka pasur për obligim qe gjate hetimit te veprës penale te analizoj provat dhe faktet fajësuese e shfajësuese dhe te sigurohet qe një hetim te kryhet duke respektuar ne tersi te drejtat e te akuzuarit dhe qe mbledhja e provave te mos behet ne kundërshtim me Kapitullin XVII te këtij kodi. Përgjegjësia penale përkatësisht fajësia, është një nder elementet e përgjithshme qe duhen te shprehen tek çdo vepër penale, kjo njëherësh është garanci e te drejtave te njeriut dhe kufizimi i se drejtës se shtetit qe ti ndëshkoj qytetaret (ius puniendi). Pra përgjegjësia penale përkatësisht fajësia , është kusht qe duhet te plotësohet doemos qe te mund ti shqiptohet dënimi kryesit te veprës penale ,parim ky qe është formësuar me maksimën “Nulla poena sine culpa” (nuk ka dënim pa fajësi). Ligdhënësi paraprakisht përcakton se çka konsiderohet dyshimi i bazuar mire dhe elementet përcjellëse qe duhet te plotësohen siç është krijimi i bindshmëris.ne nivelin me te larte te mundshëm pra me

atë forcë provuese te paerrësueshme qe mungon ne aktakuzën lëndore, pasi qe provat e prokurorisë janë te pa mbështetshme dhe krejtësisht te pamjaftueshme për te mbështetur një dyshim te bazuar mire se i mbrojturi im ka kryer vepër penale për te cilën inkriminohet. Nga te gjitha këto rezulton se me asnjë prove te vetme materiale apo personale nuk është provuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet po ashtu duke pasur mbështetje ne dispozitat ligjore dhe atë nga neni 3. Paragrafi 2 te KPP-së i cili përcakton se” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rëndësishëm për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite te ligjit penal interpretohen ne favor te të akuzuarit dhe te drejtave te tij sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetuses së Republikës së Kosovës”, e ne ndërlidhje te kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se te gjitha argumentet qe janë “ in peius” ndaj te akuzuarit duhet te vërtetohen me siguri te plote përkatësisht përtej dyshimit te arsyeshme (beyond reasonable doubt) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tille duhet te konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet qe janë “in favorem” ndaj te akuzuarit merren se ekzistojnë dhe atëherë kur janë vërtetuar me protaliet. Gjykata ne ketë çështje penale duhet qe ne kuptim te nenit 363 te KPP-së, ndaj te akuzuarit S.B. të nxjerrë aktgjykim lirues për faktin se vepra për te cilën akuzohet nuk përben vepër penale dhe se nuk është provuar me asnjë prove se i mbrojturi im ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 355 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 te KPRK-së.

I akuzuari S.B. në fjalën tij përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të paraqitur nga mbrojtësi i tij, dhe qëndroj në tërësi pranë mbrojtjes së prezantuar nga unë personalisht por edhe nga mbrojtësi im, meqenëse për asnjë moment nuk është vërtetuar se ka vepër penale siç paraqitët në aktakuzë nga prokuroria.

2.Provat e administruara

Në shqyrtim gjyqësor gjykata ka administruar provat si në vijim:

- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit I.L.;
- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit F.B.;
- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit R.H.;
- Si dhe provat materiale: Deklarata e dëshmitarit-dëmtuari I.L., të dhënë me datë 05.10.2017, në NJHF-DHKEK/ DPP në Prishtinë, Deklarata e dëshmitarit-dëmtuari F.B., të dhënë me datë 24.01.2019, në NJHF-DHKEK/ DPP në Prishtinë; Deklarata e dëshmitarit-dëmtuari R.H., të dhënë me datë 01.02.2019, në NJHF-DHKEK/ DPP në Prishtinë; Deklarata e të pandehurit S.B., e dhënë me datë 20.12.2019, në Prokurori; Lista e mallit të porositur nga

kompania B.AG., e përpiluar nga kompania “M.L.”, nga data 16.05.2014 deri më 08.12.2014; Dëftesë - transaksioni bankar TEB Banka, nr....2, e datës 14.10.2014; Dëftesë- transaksioni bankar TEB Banka, nr....4, e datës 14.11.2014; Vërtetimi i datës 05.10.2014; Kontrata gjenerale e punës, e datës 24.09.2014; Fatura e P.T., e datës 23.09.2014; Shkresa me 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe të formatit A4 nga Departamenti Federal për Ekonomi, Arsim dhe kërkim WBF i Sekretariatit për Çështje Ekonomike në Konfederatën Zvicerane; Certifikata e biznesit me numër ... në emër të “M.L.” SH.P.K.; Deklarimi i mallit gjatë kontrollit nga zyra doganore e destinacionit, gjatë periudhës 25.10.2014, 25.11.2014, 06.12.2014,10.12.2014, eksportues SHPK “M.L.”; Fatura nr.,,,, e datës 07.04.2014, N.P.T.”L.G.”; Fatura nr.,,, e datës 17.05.2014, N.P.T.”L.G.”; Fatura nr.,,,, e datës 05.06.2014, N.P.T.”L.G.”; Deklarimi i mallit gjatë kontrollit nga zyra doganore e destinacionit, gjatë periudhës 19.05.2014, 08.04.2014, 07.06.2014, eksportues N.P.T.”L.G.”; Komunikimi përmes postës elektronike – email, ndërmjet të dëmtuarve dhe të pandehurve si dhe shkresat tjera të cilat janë pjesë e kësaj lënde

2.1 Deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit I.L.

I dëmtuari – dëshmitari I.L. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.05.2021 dhe 12.07.2021, ndër të tjera ka deklaruar se: se për këtë rast i njëjti ka dhënë një deklaratë edhe në stacionin policor ku edhe qëndron pranë saj. I njëjti është pronar i firmës “M.L.” e cila funksionon që nga viti 2000. Bashkëpunimi me firmën “B.AG” ka filluar gjatë muajit mars 2014 ku është paraqitur një person dhe i ka ofruar një ofertë për bashkëpunim me një firmë zvicerane. Ai person si pronar i firmës zvicerane ia ka dhënë emrin e Zh.B. si dhe numrin e telefonit të tij, ndërsa të dhëna të tjera rreth firmës nuk i ka dhënë. Tutje i dëmtuari I.L. ka shkuar në Zvicërr dhe atje ka kontaktuar me personin Zh.B. dhe pastaj kanë kontaktuar me e-mail ku I.L. ia ka prezantuar historikun e firmës M.L. dhe ja ka dërguar fotografitë e punëtorisë. Zh.B. i është prezantuar si inxhinier- përgjegjës i punës në firmën “B.AG” për të cilën firmë i dëmtuari Isa ka kërkuar në internet dhe e ka parë se pronar është një person me shtetësi të huaj, ndërsa si i punësuar në atë firmë ka figuruar personi S.B., ndërsa sa i përket Zh.B. nuk i kujtohet se nëse emri tij ka figuruar në atë firmë, ndërsa kur e ka pyetur se kush është S.B., i njëjti i ka thënë se nuk ka lidhje familjare por është bashkëfshatar i tij. I dëmtuari I.L. për të dytën herë ka shkuar në Zvicërr në qytetin e Bazelit që të takohet me personin Zh.B. që ti pranoj projektet për të cilat kanë arritur marrëveshje gojore, pastaj janë takuar në qytetin e Bazelit në një restorant ku në atë takim ka qenë prezent edhe një person tjetër emri të cilit nuk i kujtohet. Me datë 1 maj 2014 ka pranuar një kontratë përmes emailit të firmës “B.AG” me

kushtet e së cilës i dëmtuari është pajtuar dhe e ka nënshkruar, mirëpo e njëjta nuk është kthyer e nënshkruar nga ana e firmës "B.AG". Ka deklaruar se i ka dorëzuar dy projekte dhe atë njërin me datë 16.05.2014 dhe 24.05.2014 ku e kanë ngarkuar mallin për të cilin janë marrë vesh pra gilinderat prej metalit dhe i ka nisur për në shtetin e Zvicrës të cilat mund të dëshmohen në bazë të DUD-ave doganore, ndërsa nuk ka njohuri se kur janë pranuar nga firma "B.AG", i njëjti shton se përgjegjësia e tij përfundon në momentin e dorëzimit të mallit në terminalin doganor. Zh.B. gjatë tërë kohës e ka përcjellë punën në firmën M.L.. Marrëveshjet të cilat i kanë arritur kanë qenë dakorduar që për projektet e dorëzuara pagesa të bëhet pas 60 ditësh pas pranimit të mallit, mirëpo i njëjti vetëm një pjesë të shumës ia ka paguar, ndërsa borxhi i mbetur është 50,182.09 euro të cilat nuk janë paguar nga përgjegjësi i firmës Zh.B.. Ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe të bashkëpunimit i pandehuri S.B. asnjëherë nuk ka qenë në firmën e tij dhe asnjëherë nuk ka komunikuar me këtë person dhe hera e parë kur e ka parë këtë person ka qenë në seancën gjyqësore në këtë gjykatë. Ka deklaruar se me përgjegjësi të plotë i ka përmbushur këto marrëveshje, mirëpo firma "B.AG." i ka pasur disa ankesa ndaj produkteve – gilinderave, si dhe ka shtuar se nuk ka dyshuar tek personi Zh.B. gjatë bashkëpunimit me të, por dyshimet e tij kanë lindur kur pronari i firmës "Z.U.", P.Sh. ia ka tërhequr vërejtjen.

2.2 Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit F.B.

I dëmtuari - dëshmitari F.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.09.2021, ndër të tjera ka deklaruar se: Dëshmitari ka deklaruar se ka dhënë një deklaratë ne polici dhe qëndron pranë deklaramit të tij, duke shtuar se është pronar i firmës "Q.-PE" të cilin emër e ka pasur firma ime nga themelimi i saj e cila ishte në emër të prindit tim Rushit Bakalli ndërsa nga viti 2009 unë jam pronar i saj ndërsa nga viti 2014-2015 kjo firme ka ndryshuar emrin dhe tash quhet B..M." dhe unë jam pronari i saj. Marrëveshja jonë e parë me një firme të huaj ka qenë me firmën "B.AG." ku bashkëpunimi me këtë firmë ka filluar në fund të vitit 2013 me të cilën firme kemi rënë në kontakt përmes xhaxhait tim N.B. i cili jeton në Zvicër. I kujtohet se nga mesi i viti 2013 në telefon e ka kontaktuar B.B. duke u prezantuar me emër dhe mbiemër dhe duke treguar se me çfarë merret, ku gjatë kësaj telefonate i njëjti ka kërkuar që ti bëje tri mostra të rrethojave të ballkoneve pastaj brenda tre ditësh sipas tij do të vijë një teknik i firmës së tij të cilit unë do t'ia prezantoja ato mostra dhe me kaq ka përfunduar biseda tyre. Pas kësaj thekson se është paraqitur një person me emrin Zh., ky person më tregoj se punon në pozitën e teknikut në firmën "B.AG.", biseda ime kishte të bënte lidhur me firmën ku ai përfaqësonte dhe firmën time në punën që ne kryejmë lidhur me përpunimin e metalit pastaj i njëjti shikoj tri mostrat që

ne kishim përgatitur dhe të cilat i pëlqyen pastaj më dha adresën e -mailin ku ti dërgoj këto mostra. Me anë të e-mailit ka pranuar kontratën e cila kontratë ishte në gjuhë gjermane e cila nuk ishte as e nënshkruar nga ana e firmës "B.AG." dhe as e vulosur pastaj të njëjtën e kam dërguar tek një shok imi që ta përkthej nga gjuha gjermane më njoftoj se në atë kontratë shkruante se sipas pranimit të punës së kryer nga ana e ime pra rrethojave të ballkoneve pagesa do të bëhej brenda 60-90 ditësh të cilën gjë unë nuk e pranova dhe nuk e nënshkruajta atë kontratë ku kontaktova me B. përmes telefonit dhe i thashë të njëjtit se në kontratën që ju keni dërguar në e-mailin tim nuk shkruan ajo për të cilën jemi marrë vesh përmes telefonit, i njëjti më tha që ajo kontratë është vetëm për çështje të brendshme të firmës mirëpo mos u shqetëso se pagesën për punën e kryer do ta pranosh ashtu si jemi marr vesh në telefon ndërsa çmimin për të cilin ishim marrë vesh me këtë firmë ishte njëjti edhe në atë kontratë, ku për 36 euro për metër gjatësi dhe atë për 200 metra linear shuma e përgjithshme që të njëjtit do të kryenin ndaj meje ishte rreth 7,200.00 euro. Pas kësaj bisede unë e nënshkruajta kontratën dhe e vulosa në emër të firmës dhe të njëjtën e dërgova prapë në e-mailin me të cilin kemi kontaktuar, mirëpo unë nuk e kam pranuar këtë kontratë të nënshkruar nga ajo firmë dhe nuk kam kërkuar sqarim për nënshkrimin e saj dhe vazhdova ta kryej punën si ishim marrë vesh duke u besuar fjalëve të B. me të cilin kemi folur në telefon dhe atë shumë shpejtë pra pas disa ditëve, pastaj Zh. pas një jave apo 10 ditë ka ardhur në firmën time dhe ka shikuar si është duke shkuar puna dhe për ta kontrolluar atë, mënyra se si ai ka bërë kontrollimin e punës ka qenë në bazë të vizatimeve që ai i posedonte si dhe gojarisht na ka njoftuar se puna në firmën tonë është duke shkuar shumë mirë, ku pastaj i kam nisur materialet për në Zvicër. Për punën që ne kemi kryer në vazhdim për këtë firmë pra gjatë fundit të vitit 2013 shuma që është arritur për punën e kryer e cila është paguar në tërësi nga firma "B.AG." ka qenë 20,609.00 euro sipas raportit të cilin unë e kam nxjerrë në firmën time prej të cilave një herë më është paguar shuma prej 4,859.09 euro, pastaj shuma tjetër prej 9,995.85 euro, ndërsa kanë mbetur pa u paguar dhe 5,895.09 euro gjatë vitit 2013 dhe atë nga shuma e përgjithshme prej 20,609.00 euro këto pagesa unë i kam pranuar në emër të firmës "B.AG." ne xhirollogarinë time në "R.B.".

Gjatë vitit 2014 në prapë kemi pranuar vizatime të reja për kryerjen e punëve për këtë firmë dhe ne kemi vazhduar punën tonë për tu dërguar mallin pavarësisht borxhit i cili ka mbetur në vitin 2013 i cekur më lartë, edhe gjatë këtij viti ne kemi pasur probleme me këtë firmë sa i përket pagesës së obligimeve ndaj neve, dërgesën e fundit ne për këtë firmë e kemi bërë me datë 04.08.2014 dhe atë rrethojat e ballkoneve në shumë të përgjithshme prej 4.658.33 euro ku me këtë ngarkesë dhe borxhi paraparak i këtij viti ka qenë në shumë të përgjithshme prej 43,845.11 euro në të cilin vit ju njoftoj se është bartur edhe borxhi i mbetur në vitin 2013 dhe

atë 5,859.09 euro. Ju njoftoj se gjatë vitit 2014 në bisedat tona telefonike është kyçur edhe personi me emrin S.B. të cilin gjatë këtij viti nuk e kam takuar asnjëherë fizikisht dhe atë në numrin e firmës në të cilin unë kam kontaktuar me personin S.B., gjithashtu ju njoftoj se me këtë person unë kam biseduar pas dërgesës së fundit të dërguar për firmën “B.AG.” dhe atë kur kam kërkuar nga kjo firmë përmbushjen e obligimit ndaj meje dhe atë duke iu bërë presion përmes telefonatave në numrin e firmës duke kërkuar nga të njëjtit pagesën e borxhit ku nga ato telefonata ka pasur raste kur nuk është lajmëruar askush, raste kur është lajmëruar një person ka folur në gjuhën gjermane ndërsa në një tërën nga këto telefonata kam biseduar me S.B. të cilën nuk më kujtohet saktë a e kam thirrur unë apo ai, ose unë të cilit i kam kërkuar sqarime për mos pagesën e borxhit ndaj meje i cili më premtoi se do ta përmbushë obligimin ndaj meje ku pas bisedës me të kam pranuar në llogarinë time të cekur më lartë shumë prej 9,973.83 euro dhe atë nga emri i firmës “B.AG.” kam pranuar me datë 23.04.2014. Ju njoftoi se ngarkesa ime e fundit për firmën “B.AG.” ka ndodhur në muajin e tretë dhe jo në muajin e tetë siç kam deklaruar më lart dhe kjo ka ndodhur për shkak të një gabimi teknik që e kam në raportin e bërë nga firma ime. Pastaj me datë 24.06.2014 unë kam pranuar shumë tjetër të borxhit dhe atë në shumë prej 12,473.00 euro dhe pagesa e fundit e vitit 2014 ka qenë me datë 25.11.2014 në shumë prej 4,959.27 euro ku nga këto pagesa borxhi që ka mbetur i pa paguar ka qenë në shumë prej 16,439.01 euro. Ju njoftoj se pas pagesës së fundit të bërë në muajin nëntor të vitit 2014 që e ceka më lartë më nuk kam pranuar asnjë pagës nga firma “B.AG.” për borxhin e mbetur si dhe nuk më ka kontaktuar askush nga kjo firmë në telefon dhe askush nuk ja ka hapur telefonat e mija përveç disa herë gjatë thirrjeve të mija është lajmëruar S.B. dhe këto thirrje i kam të regjistruara në rrjetin “Whatss App” i cili më ka dhënë përgjigje pozitive që këtë shumë të borxhit do ta paguaj shumë shpejt si dhe mos më kujtohet gjatë kësaj periudhe pra gjatë vitit 2015 unë kam pranuar edhe një e-mail nga i cili S.B. më ka premtuar se do ta përmbushë obligimin ndaj meje i cili e-mail është dërguar nga e-maili i firmës “B.AG.” ose nga e-maili i S.B. mirëpo saktë nuk më kujtohet por në e-mail është e bashkangjitur në shkresat e lëndës, ndërsa me B. dhe Zh. nuk kam biseduar më asnjëherë nuk më ka hapur telefonin. Ju njoftoj se në vitin 2020, dhe atë me sa më kujtohet pas seancës së parë që e kemi mbajtur këtu në gjykatë, më ka kontaktuar S.B. me telefon dhe jemi takuar fizikisht në zyrën e firmës sime i cili ishte i vetëm, ku gjatë këtij takimi prapë biseduam për borxhin dhe i njëjti më premtoj që do të bëj qmos që të ma paguaj borxhin dhe e ndjente veten keq për këtë çfarë ka ndodhur deri më tash. Me datë 09.12.2020, unë kam pranuar 4,977 euro, me datë 28.12.2020 kam pranuar shumë në vlerë prej 4,958.99 euro, me datën 01.04.2021 kam pranuar shumë prej 4,959.31 euro dhe pagesa e fundit e mbetur është bërë me datë 12.04.2021 në shumë prej 1,467.15 euro

në llogarinë bankare të firmës sime “B..M.” dhe atë nga firma “M.L.GMBH” dhe atë në shumë të përgjithshme prej 16,362.45 euro, ku me ndalesa bankare është përmbushur borxhi prej 16,439.01 euro të cilin e kishte firma “B.AG.” ndaj firmës sime. Është e vërtetë se tani i akuzuari sa herë më ka takuar më ka njoftuar se arsyet e mos përmbushjes së obligimit janë vështirësitë financiare.

2.3 Deklarata e dëshmitarit R.H.

I dëmtuari – dëshmitari R.H. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës se dhënë në stacion policor në Prishtinë data e së cilës saktë nuk më kujtohet mirëpo e di se ka qenë para dy viteve, ndërmarrja “L.G.” merret me përpunimin e qelqit dhe aluminit e cila është në funksion nga viti 2000. Gjatë veprimtarisë së biznesit të tyre kanë bashkëpunuar me firma të ndryshme ndër to edhe me firmën “B.AG.” e cila selinë e saj ka pasur në qytetin e Cyrihut në Zvicër. Gjatë muajit Janar të vitit 2014 i dëmtuari është takuar me babain e S. ku ai person është prezantuar si pronar i firmës “B.AG.” dhe më ka njoftuar se firma e tij në Zvicër merret me ndërtimtari dhe arsyeja pse dëshiron të bashkëpunoj me firmën time është se i nevojiten këto materiale për përfundimin e objekteve të cilat firma e tij i punon në Zvicër, ku atë ditë kanë arritur një marrëveshje gojore lidhur me bashkëpunimin e tyre. I dëmtuari ka deklaruar se bashkëpunimi jonë ka filluar në muajin Prill 2014 ku nga firma “B.AG.” ne kemi pranuar kërkesën e parë në formë të shkruar përmes e-mailit në emër të firmës “B.AG.”, për të cilën kërkesë ne kemi përgatitur ofertën dhe e kemi dërguar prapë me anë të e-mailit në adresën e njëjtë ku kemi pranuar kërkesën, në të cilën ofertë ne kemi shkruar të gjithë materialin në dimensionet e kërkuara nga firma “B.AG.” si dhe çmimet për çdo material ku në shumë të përgjithshme kjo ofertë ka qenë në shumë prej 5,913.31 euro, ku pas konfirmimit ne kemi filluar punimin e materialeve sipas kërkesës së kësaj firme, ku edhe e ka kontrolluar punën tonë personi Zh.B. si përfaqësues i firmës B.AG., pas përfundimit të kësaj kërkesë pagesa është kryer në tërësi. Pas përfundimit të bashkëpunimit të parë mes nesh ne kemi filluar të bashkëpunojmë prapë ku me datë 17.05.2014 firma jonë përmes e-mailit të firmës “B.AG.” kemi pranuar kërkesën e radhës për bashkëpunim mes nesh. Ne për këtë kërkesë kemi punuar ofertën në shumë prej 5,083.45 euro dhe të njëjtën e kemi dërguar në emailin e firmës “B.AG.” e cila ofertë prapë është pranuar dhe është konfirmuar nga e-maili në emër të firmës “B.AG.” dhe ne kemi filluar punimin materialit sipas kësaj oferte, mirëpo për shkak të mungesës së materialit nga ana e furnitorëve ne kemi njoftuar Zh.B. përmes telefonit për mungesën e materialit dhe se kjo ofertë nuk mund të përmbushet në tërësi, nga i njëjti kemi marrë

konfirmimin që ai material të dërgohet aq sa ka arritur të përfundohet ku sipas nesh ka qenë e përmbushur rreth 90% dhe na ka njoftuar se për shkak që gjendet në një shtet tjetër jo në Zvicër dhe nuk mund të vij ta kontrolloj materialin siç jemi marrë vesh dhe siç ka vepruar në ofertën e parë ne e kemi përgatitur faturën nga ana e zyrës financiare dhe është nënshkruar nga drejtori i kësaj zyre. Tutje ka deklaruar se shuma e ofertës së dytë të cilën e kanë përfunduar dhe e kanë dërguar për në shtetin e Zvicrës ka qenë 5,083.45 euro. Pas kësaj drejtori financiar i firmës sime ka biseduar me Zh.B. në telefon ku e kemi njoftuar se është dorëzuar materiali dhe nga ana e tij ne jemi njoftuar se pasi që oferta e dytë nuk është përmbushur në tërësi e njëjta do të përmbushet pasi të pranohet kërkesën e tretë nga ana e tyre dhe pagesa e ofertës së dytë do të bëhet pas përfundimit të ofertës sipas kërkesës së tretë që do të pranoni pra do të paguhet të dyja së bashku, ku pastaj është vazhduar edhe me ofertën e tretë, mirëpo këtu ka ndërhyrë një person i tretë me emër A.L. i cili është nip i familjes B. i cili ka marrë përsipër në emër të firmës "B.AG" do ti kryej obligimet në rast se të njëjtit nuk u përmbahen dy faturave të lartcekura. Pasi kemi dërguar materialet sipas ofertës së tretë dhe një pjesë të ofertës së dytë drejtori financiar i firmës sime ka tentuar të komunikoj me Zh.B. përmes telefonit të tij që kemi komunikuar më herët mirëpo ai numër më nuk ka funksionuar ku ne kemi dërguar edhe e-mail në emër të firmës "B.AG." por deri me datë 09.07.2014 asnjëherë nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga firma ""B.AG." edhe pse ne kemi tentuar me anë të e-mailit të komunikojmë me ta. Me datë 09.07.2014 nga ana e firmës sime "L.G." është dërguar një e-mail tek e-maili i firmës "B.AG." në gjuhën gjermane ku kemi kërkuar pagesën e dy faturave të fundit që ne kemi dorëzuar materialin tek firma "B.AG. ku me datë 26.07.2014 ne kemi pranuar një e-mail nga firma ""B.AG." por kësaj radhe në të ka qenë emri i personit M.K. gjë e cila nuk ka ndodhur në asnjë e-mail të mëhershëm të komunikimit tonë me sa më kujtohet, e cila përmes këtij e-maili në gjuhën gjermane jemi njoftuar se deri me datë 12.08.2014 firma është në pushim vjetor si dhe pagesa ndaj jush do të kryhet si të kthehemi nga pushimi, mirëpo edhe pas asaj date nuk është kryer obligimi. Edhe pas tentimit të fundit me e-mail ne prapë kemi vazhduar të kërkojmë nga ana e kësaj firme përmbushjen e obligimit të tyre ku me personin që e ceka më lartë pra A.L. i cili është nip i familjes B. kemi shkuar tek familja e B. në Gjakovë por nuk më kujtohet se në cilin vit ku aty është paraqitur një person si vëllai i pronarit të firmës ""B.AG." mixha i Zh.B. i cili na ka njoftuar se është njohuri se firma e vëllait të tij ka falimentuar. Personat me emrin I.L. dhe F.B. nuk i kam njohur më herët por tash me zhvillimin e kësaj procedure të njëjtit i njoh dhe jam takuar me ta vetëm kur jemi ftuar në seanca gjyqësore dhe takime jashtë kësaj procedure nuk kemi pasur. Me të akuzuarin S.B. i cili akuzohet në këtë çështje penale nuk jam takuar asnjëherë por pas shqyrtimit gjyqësor kemi

biseduar përmes telefonit dhe atë kemi komunikuar me anë të sms në rrjetin whats app më ka pyetur mua se sa është shuma e obligimit që kompania "B.AG." ka ndaj firmës sime "L.G.", ku unë e kam pyetur për pozitën e tij në firmën "B.AG." dhe ai më ka njoftuar se është aksionar i kësaj firme dhe gjithashtu më ka njoftuar se i njëjti është djali i pronarit të firmës "B.AG." B.B. dhe vëllai i Zh.B.. Gjithashtu ju njoftoj se edhe me avokatin mbrojtës të pandehurit av. Urim Pozhegu kam biseduar përmes telefonit ku ai me ka thirrur mua dhe ka shprehur interesim si avokat i të pandehurit që të arrihet një marrëveshje me të dhe S.B. pasi këtë ia ka kërkuar S. për të cilën unë kam shprehur interesim mirëpo deri me sot nuk ka ndodhur diçka e tillë. Obligimi i firmës "B.AG." ndaj meje është: dy fatura shuma e të cilave është 5,083.45 euro sipas faturës se dytë si dhe 8,678.54 euro sipas faturës se tretë si dhe shuma prej 3,000 euro e cila ka të beje me pagesën e transportit për materialin e dërguar sipas faturës se tretë e cila në shume të përgjithshme është 16,761.99 euro. I dëmtuari - dëshmitari R.H. në fund ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale për të pandehurin S.B., mirëpo jam i interesuar që me të njëjtin të arrij marrëveshje dhe të më kthehet obligimi që kanë ndaj meje dhe paraqet kërkesë pasurore juridike për çdo lloj të demit tjetër që më është shkaktuar nga ky rast.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: firma "B.AG." është themeluar në muajin e gjashtë të vitit 2012, ndërsa është regjistruar në Kantonin e Cyrihit me datën 19.12.2012, si bashkëthemelues i kësaj firme është S.B.1., në organet kompetente të shtetit të Zvicrës, përkatësisht në kantonin e Cyrihut. Nga data e themelimit të kësaj firme ne kemi bashkëpunuar me firma të ndryshme si brenda shtetit të Zvicrës dhe jashtë saj dhe për këto bashkëpunime gjithmonë kemi përpiluar kontratë. Nga fillimi i punës së kësaj firme ne kemi funksionuar shumë mirë për shkak që kemi marr shumë kontrata për punë deri kur filluan ngecjet-problemet për shkak të materiale. Në këtë kompani nuk ka punuar B.B., ndërsa Zh.B. ka qenë i punësuar në firmën time për një kohë të shkurtër për afërsisht gjashtë muaj në cilësi të punëtorit të thjeshtë. Sot kjo firmë nuk është aktive në shtetin e Zvicrës, për shkak se ka filluar falimentimi i kësaj kompanie në muajin maj të vitit 2016. Fillimi i falimentimi ka filluar në muajin maj të vitit 2016 dhe ka zgjatur dy vite pra deri në vitin 2018 kur edhe ka pushuar. Dhe pasi që kjo firmë nuk është aktive dokumentet e saj gjenden në Gjykatën e Kantonit të Cyrihut dhe nuk me lejohet që të kem qasje në ato dokumente për shkak se në vitin 2016 ka filluar falimentimi i saj dhe kompetente tash për këtë firmë është gjykata që e ceka më lartë dhe unë nuk kam më kompetenca lidhur me këtë. Ju njoftoj se unë kam tentuar që ti marr

dokumentet përkatëse që kanë të bëjnë me falimentimin e firmës time mirëpo nga ana e tyre jam njoftuar se ju nuk mund të merrni asnjë nga këto dokumente dhe informacione sepse këto mund të nxirren vetëm nga organet kompetente. Gjatë vitit 2014, firma ime ka pasur bashkëpunim me tri firma nga shteti i Kosovës dhe atë: kompaninë “M.L.”, kompaninë “L.G.”, si dhe firmën e z.B.. Me firmën “M.L.” kemi pasur kontratë për kryerjen e punëve nga kjo firmën për firmën time dhe atë për përpunimin e konstruksioneve nga hekuri dhe në fillimin e bashkëpunimit tonë i njëjti ju është përmbajtur kontratës dhe kërkesave tona, obligimi ynë është përmbushur nga ne përmes bankës, pra është fjala për vitin 2014. Me kohe ne kemi kërkuar shtimin e punës nga ana e kompanisë “M.L.” pasi që e njëjta në fillim ka qenë shumë kompani serioze dhe i ka përmbushur kërkesat tona, mirëpo pasi që kemi kërkuar punë shtesë nga i njëjti për shkak të numrit të punëtorëve në firmën e tij, vend punishten e tij, gjendjes financiare nuk ka mundur t’ju përmbahet kërkesave tona dhe ka kërkuar ndihmë nga kompania “B.AG.”, ku i kemi blerë material hekur nga një kompani tjetër Italiane dhe atë rreth 20 ton, gjithashtu të cekti se kontratën të cilën e kemi nënshkrua firma jonë me kompaninë “M.L.” ka pasur të përcaktuar edhe penalltinë për mos përmbushjen e punës pasi që unë kam pasur të kontraktuar firma në Zvicër për ti pajisur me materiale që kam pasur kontratë me firmën “M.L.” dhe për shkak se nuk kemi pasur kohe që të kontraktojmë firma tjetër është dashur të vazhdojmë punët me këtë firmë. Më kujtohet që shuma prej 9,600 euro, vëllai im Zh.B. ja ka dërguar I.L. në firmën tij dhe atë para kesh për të cilën Isa e ka skenuar dhe e ka dërguar në e-mailin zyrtar të firmës dhe këto para nuk më kujtohet saktë a i ka dërguar për materialin e ne e kemi pranuar nga ai apo për materialit që do të punoj në të ardhmen. Firma M.L. me pronar I.L., me nënshkrimin te tij i ka pranuar të gjitha kushtet e kontratës me të drejtat dhe detyrimet e tij, mirëpo nga firma nuk është marr seriozisht kjo kontratë, për të gjitha kërkesat e kësaj kontrate që kanë të bëjnë me materialin, cilësinë e tij, afatet e përmbushjes së saj dhe komunikimet që kemi pasur me këtë firmë përmes emal-it zyrtar. Çdo herë kur kemi pranuar materialin nga kjo firmë ne kemi bërë protokoll të pranimit të saj dhe në rast se ka pasur vërejtje të vogla që janë parë me sy ne i kemi fotografuar dhe i kemi dërguar me e-mail në firmën M.L. ndërsa vërejtjet e mëdha që i kemi pasur lidhur me këto materiale janë vërejtur pas një kohe, pra janë dërguar për montim tek firma tjetër kontraktuese në Zvicër ku kemi pasur ti dërgojmë ku pastaj edhe ato i kemi bërë fotografi “duke prezantuar fotografi në këtë shqyrtim”, të bëra në vendin e ngjarjes pasi që janë montuar gilinderat nga materiali metal në firmat kontraktuese në Zvicër si dhe prezanton fotografitë në vizatim në skica se si është dashur të përfundohet ato materiale dhe nuk janë përfunduar dhe atë me probleme të ndryshme sa i përket ndryshkjes së materialit si ka ardhur në shtetin e Zvicrës pastaj problemet

të tjera në matje e gjëra të ndryshme që nuk ju ka përmbajtur kërkesës së saj. Përveç materialit që nuk e ka respektuar sipas planit tonë, ne kemi pasur problem me këtë firmën edhe në respektimin e terminëve në dërgimin e materialit. Ju njoftoj se pasi ne kemi pranuar materiale nga kjo firmë por të cilat nuk kanë qenë të punuara sipas kërkesës sonë kur i kemi dërguar te firma tjetër kontraktuese për montim nga ajo firmë nuk janë pranuar dhe ne jemi detyruar që ti kthejmë në firmën tonë të cilat jemi detyruar ti riparojmë ne vet për të cilat kemi përpiluar faturë dhe të cilën e kemi dërguar në e-mail te firma M.L.. Ju njoftoj se njëra nga këto firma kontraktuese në shtetin e Zvicrës ku kemi pasur të montojmë këto materiale dhe për shkak se nuk e kemi montuar sepse nuk kanë qenë të punuar sipas kërkesës sonë e ka shkëputur kontratën me firmën “B.AG.” për shkak të mos përmbushjes së saj. Gjithashtu ju njoftoj se nga firma “M.L.” edhe materiale të cilat nuk kanë mundur të riparohen e të cilat kanë mbetur në punishten e firmën “B.AG.”, të pa funksionuar e të cilat materiale pasi ka filluar falimentimi i firmës tonë janë konfiskuar nga shtetit i Zvicrës për shkak se lokali që ndodhej firma jonë ka qenë me qira dhe është dashur të mbyllet ku sasia e këtij materiali ka qenë shumë e madhe, por nuk e di saktë. Unë në Zvicër kam pasur kontratë për dërgimin e këtyre materialeve me firmën “P.” në Zvicër dhe për shkak të materialit që e ceka më lartë e njëjta e ka ndërprerë kontratën me firmën “B.AG.”, ku për këtë jemi ndëshkuar – penalltuar sipas kontratës dhe atë ndëshkimi në njërën prej objekteve që kemi pasur ti dërgojmë këto materiale ka qenë 300.000 franga, ndërsa në objektin tjetër 200.000 franga. Përveç kontratës se lartë cekur me firmën M.L. ne kemi lidhur edhe kontrata të tjera dhe atë: për dërgimin e profileve të aluminit dhe llamarinës se krumuar CNS, të cilat materiale ne i kemi porositur nga kjo firmë mirëpo këto dy dërgesa sipas këtyre kontratave nuk janë përmbushur asnjëherë nga firma M.L. dhe për këto ne jemi ndëshkuar nga firma tjetër kontraktuese në Zvicër. Vlera totale e ndëshkimit të pranuar firma “B.AG.”, nga firma kontraktuese në Zvicër “P.” ka qenë 500,000 franga. Me firmën “M.L.” në fillim materialet kanë qenë sipas kërkesës së firmës “B.AG.”, mirëpo kur është rritur kërkesa jonë për material, atëherë kemi pasur probleme në cilësi të materialit, ndërsa sa i përket firmës “B..M.” bashkëpunimi nga fillimi deri në fund ka qenë shumë i mirë. Gjithashtu edhe me firmën “L.G.” bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë vetëm disa vërejtjeve të vogla të cilat i kemi zgjidhur me marrëveshje. Ndaj kompanisë “B..M.” unë e kam përmbushur në tërësi obligimin që e kam pasur ndaj kësaj firme dhe këtë obligim e kam përmbushur gjatë vitit 2021. Ndërsa sa i përket firmës “L.G.” nuk e kam përmbushur obligimin tim që e kam pasur ndaj tij me sa më kujtohet është rreth 13,000 euro dhe arsyeja pse nuk kam përmbushur është se nuk kam pasur mundësi financiare për shkak të falimentimit të firmës “B.AG.”. Në komunikimin e datës 20.02.2015 janë të specifikuar nga kompania “P.AG”, materialet e dorëzuara me mangësi të

mëdha dhe atë në faqen 1 të këtij komunikimi tek rreshti 2 është shënuar “pozita... si dhe rreshti 7 është e shënuar prapë pozita... dhe në fund 20 % e montuar me mangësi të mëdha si dhe në faqen e dytë të këtij komunikimi kur na është kërkuar korrigjimi i këtyre mangësive. Ne kemi përpiluar kontratën dhe përmes emailit e kemi dërguar në e-mailin zyrtar të firmës M.L. dhe pasi është nënshkrua nga kjo firmë dhe atë me pronat I.L. është kthyer prapë me emaili e nënshkruar dhe pastaj e kam nënshkruar unë dhe të nënshkruar nga ana ime nuk e kam kthyer me e-mail por me post, dhe nuk më kujtohet nëse I. e ka pranuar me postë këtë e-mail, pikat kryesore të kësaj kontrate kanë qenë lënda e kontratës që ka prodhimi i punëve të ndryshme, terminet dhe koha e këtyre dërgesave sa i nevojitet pastaj është çmimi dhe për çdo punë shtesë të bëhet një ofertë e veçantë jashtë kësaj kontrate dhe pastaj të pranohet dhe kryhet pagesa si dhe shumë kushte tjera të kësaj kontrate, pra kjo është kontrata e parë dhe gjenerale e punëve të përgjithshme dhe të ndryshme pa i specifikuar ato ndërsa për çdo punë të veçantë dhe specifike që kemi kontraktuar një kontratë të veçantë për atë punë specifike që kemi bërë. Po kemi biseduar me I.L.n edhe brenda kësaj periudhe prej datës 25 tetor 2014 e deri me datën 17.02.2015 dhe besoj që i kam edhe ato komunikime ku unë e kam informuar për jo cilësinë e materialit dhe në fund të këtij e-maili dëshmohet se unë dhe M.L. kemi komunikuar me datë 30.12.2014 pasi që gabimisht është shënuar 2015 dhe e kam njoftuar se materialet e dërguar nga ai nuk janë pranuar ku edhe i kemi shënuar dëmet të cilat janë shkaktuar firmës tonë të cilat janë të cekura në këtë emaili janë për shkak të materialeve jo cilësore nga firma M.L. ku kemi bërë edhe llogaritjen e atyre materialeve dhe dëmet që janë shkaktuar në shumën e përgjithshëm 54,035.10 franga si dhe për këtë e-mail nuk e di se a kam pranuar përgjigje nga M.L.. Këta tre persona që në këtë çështje penale janë si të dëmtuar dhe si përfaqësues i firmave që unë kam bashkëpunuar i kam takuar për herë të parë në seancën fillestar në këtë seancë, përveç F. të cilin e kam njohur gjatë bashkëpunimit tonë dhe me këta dy personat kemi kontaktuar vetëm përmes e-mail-eve dhe asnjëherë në formë të tjera gjatë bashkëpunimit tonë. Ju njoftoj se pasi kemi filluar shqyrtimin e kësaj çështje unë ja kam paguar të gjithë borxhin F.B.t, ndërsa me R.H.n kemi biseduar një herë për arritjen e marrëveshjes lidhur me borxhin, mirëpo ende nuk kemi arritur, ndërsa sa i përket borxhit të cilën e ka potencuar I.L. të njëjtin nuk e pranoj pasi që nuk ja ka borxh ish firma ime. Nuk e di nëse faturën në të cilën janë të shënuar materialet e dërguara dhe borxhin të cilën ish firma ime e ka ndaj kompanisë L. e cila u prezantua sot nga avokati i tij, por jam në njohuri se kjo faturë gjendet tek avokati im që më përfaqëson mua. Gjithashtu në këtë kontratë e nënshkrua nga M.L. dhe të cilën e kam përpiluar unë si bashkëpronar i firmës “B.AG.”, njëra ndër kushtet e saj është se në rast kontesti lidhur me këtë kontratë kompetente do të jetë gjykata e Kantonit të Cyrhit, mirëpo nuk kam mundur ti

drejtohem kësaj gjykate për shkak se firma ka falimentuar. Deklaroj se unë nuk kam fshehur asgjë kur kam hyrë në marrëdhënie me këto kompani dhe kam qenë absolut transparent, ku “L.G.” ka qenë transparent dhe nuk kam vërejtje, po ashtu edhe “B..M.” nuk ka vërejtje ndërsa “M.L.” si kompani nuk ka qenë në gjendje që ti përmbushë obligimet për të cilat jemi marrë vesh as në aspektin financiar dhe as me kapacitetin e punëtorisë dhe prodhimit dhe nuk kanë pasur profesionalizimin e duhur për ta përmbushur.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundur të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç’rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Për të gjitha palët nuk ishte kontestuese se biznesi “B.AG.” me bashkëpronar S.B. ka pasur raport ekonomik me kompaninë SH.P.K. “M.L.” me pronar I.L., NPT. “L.G.” me pronar R.H. dhe NPT “B..M.” me pronar F.B..

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së të dëmtuarit - dëshmitarit – I.L., pasi që i njëjti saktë e ka përshkruar ngjarjen se si fillimisht janë takuar me Zh.B. dhe kanë bërë një marrëveshje për të bashkëpunuar me biznesin “B.AG.”, ku edhe një bashkëpunim i tillë ka ndodhur, mirëpo i dëmtuari – dëshmitari I.L. përveç që ka kërkuar t’i kthehet borxhi ku sa i përket S.B. kërkesa pasurore juridike është 59,782.09 euro dhe nga dëshmia e të njëjtit gjykata gjeti se i dëmtuari dhe i pandehuri kanë pasur mosmarrëveshje sa i përket raportit të tyre

ekonomiko – juridik ku biznesi “B.AG.” është ankuar në cilësinë e materialeve të pranuar nga Sh.P.K. “M.L.”, kurse pala e dëmtuar i ka mohuar këto ankesa në cilësi duke theksuar se materialet kanë qenë në rregull kurse i pandehuri nuk ia ka paguar detyrimet të dëmtuarit pikërisht duke u thirrur në pretendimet e lartcekura.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit – F.B.t, i cili e shpjegoi rrjedhimisht ngjarjen se si ka ndodhur që nga fillimi ku kishin nënshkruar një marrëveshje me firmën “B.AG.” dhe kishin filluar bashkëpunimit mes tyre me të cilin kishin qenë të kënaqur të dyja palët, mirëpo pasi firma “B.AG.” kishte vështirësi ekonomike nuk ka arritur tia paguante obligimet që i kishte ndaj të dëmtuarit F.B. me kohë, mirëpo pas disa takimeve dhe telefonatave që i kishin mes vete firma “B.AG.” të dëmtuarit ia ka kryer të gjitha obligimet. Gjithashtu ky i dëmtuar – dëshmitar në deklarin e tij asnjëherë nuk ka përmendur asnjë fakt të cilin ia ka fshehur S.B. rrjedhimisht nuk ka theksuar se në çfarë mënyre e ka mashtruar i pandehuri, madje ai shprehimisht ka deklaruar se tani i akuzuari S.B. kur ka kontaktuar me të asnjëherë nuk e ka mohuar borxhin përkundrazi i ka kërkuar kohë për pagesën e borxhit me arsyetimin se ka vështirësi financiare. Andaj nga deklarinet e dëshmitarit-të dëmtuarit nuk është vërtetuar se i akuzuari me anë të paraqitjes së rreme ka paraqitur ndonjë fakt apo ka fshehur faktet me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit – dëmtuarit R.H. i cili tregoi ngjarjen kronologjikisht se si ka ndodhur bashkëpunimi në mes firmës së tij dhe firmës “B.AG.”, ku së bashku kishin lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ku firma “B.AG.” i kishte ofruar tri oferta “L.G.”, ofertën e parë të cilën e kishin përfunduar iu është paguar me rregull, mirëpo ofertën e dytë dhe të tretë nuk ia kishin paguar me kohë për shkak të vështirësive ekonomike, mirëpo përmes mbrojtësit të tij ka negociuar me të dëmtuarin për t’ia paguar obligimet të cilat i kanë mbetur firma “B.AG.”, pra nga deklarinet e dëshmitarit – të dëmtuarit kjo çështje zë vend në kontestin juridiko civil. I njëjti në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *“nga S.B. personalisht nuk ndjehem i mashtruar por ndjehem i mashtruar nga babai i tij B.B. dhe nga vëllai i tij Zh.B....”*.

Gjykata ai fali besimin mbrojtjes së të pandehurit S.B. pasi që deklarimi i të njëjtit është në përputhje me provat tjera të administruara në këtë çështje penale. Nga deklarimi i tij gjykata gjeti se firma e të pandehurit “B.AG.” kishte bashkëpunuar me firmat e të dëmtuarave mirëpo i

njëjti nuk e ka paraqitur asnjë fakt të rremë apo as nuk u ka fshehur asnjë fakt të dëmtuarve me qëllim që të realizoj dobi pasurore për vete apo për personin tjetër apo tu shkaktoj dëm palëve të dëmtuara. Tutje nga mbrojtja e të akuzuarit gjykata gjeti se i akuzuari dhe pala e dëmtuar kanë pasur mosmarrëveshje sa i përket raportit të tyre ekonomik – juridik ku biznesi “B.AG.” është ankuar në cilësinë e materialeve të pranuar nga Sh.P.K. “M.L.”, kurse pala e dëmtuar i ka mohuar këto ankesa në cilësi duke theksuar se materialet kanë qenë në rregull kurse i pandehuri nuk ia ka paguar detyrimet të dëmtuarit pikërisht duke u thirrur në pretendimet e lartcekura. Kurse sa i përket të dëmtuarit R.H. i njëjti e ka pranuar se i ka borxh dhe është zotuar se do t’ia kthej ndërsa të dëmtuarit F.B. ia ka përmbushur obligimin në tërësi.

Nga Lista e mallit të porositur nga kompania B.AG., e përpiluar nga kompania “M.L.”, nga data 16.05.2014 deri më 08.12.2014 gjykata gjeti llojin e materialit, sasinë dhe vlerën e materialit në bashkëpunimin ekonomik mes këtyre dy bizneseve.

Nga dëftesa - transaksioni bankar TEB Banka, nr....., e datës 14.10.2014, gjykata gjeti se është kryer pagesa në vlerë prej 10,005.09 euro, lidhur me pagesën për gilindera shkallë, gilindera terase, shkallë spirale, gilindera spirale, konstruksione terase etj.

Nga dëftesë- transaksioni bankar TEB Banka, nr....., e datës 14.11.2014; gjykata gjeti se është kryer pagesa në vlerë prej 14,913.88 euro, lidhur me pagesën për gilindera shkallë, gilindera terase, shkallë spirale, gilindera spirale, konstruksione terase etj.

Nga Vërtetimi i datës 05.10.2014 gjykata gjeti se i dëmtuari I.L. me datë 05.10.2014, i pranoi 9,600 euro në shfrytëzim nga z. Zh.B..

Nga Kontrata gjenerale e punës, e datës 24.09.2014 gjykata gjeti se B.AG. dhe M.L. kanë arritur një marrëveshje mes vete ku i kanë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Fatura e P.T., e datës 23.09.2014 gjykata gjeti se totali për pagesë është në vlerë prej 13,720.18 euro;

Nga Shkresa me 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe të formatit A4 nga Departamenti Federal për Ekonomi, Arsimit dhe kërkim WBFI Sekretariatit për Çështje Ekonomike në Konfederatën Zvicerane gjykata gjeti se “B.AG.” e ka deklaruar falimentimin me datë 25.05.2016 dhe ka falimentuar me datë 19.12.2017;

Certifikata e biznesit me numër ... në emër të “M.L.” SH.P.K. gjykata gjeti se ky biznes është regjistruar në vitin 2011 dhe pronar i të njëjtit është I.L..

Nga deklarimi i mallit gjatë kontrollit nga zyra doganore e destinacionit, gjatë periudhës 25.10.2014, 25.11.2014, 06.12.2014,10.12.2014, eksportues SHPK “M.L.” gjykata gjeti se “M.L.” ka eksportuar për “B.AG.” rrethoja – gilindera prej hekuri, grilla, rrjeta dhe gardhe të tjera.

Nga deklarimi i mallit gjatë kontrollit nga zyra doganore e destinacionit, gjatë periudhës 19.05.2014, 08.04.2014, 07.06.2014, eksportues N.P.T.”L.G.” gjykata gjeti se N.P.T.”L.G.” ka eksportuar për “B.AG.” vitrina alumini të çmontuara me qelq , qelq jo i armuar, jo i tejdukshëm, qelq termoizolues.

Nga Komunikimi përmes postës elektronike – email, ndërmjet të dëmtuarve dhe të pandehurve gjykata gjeti se janë dhënë rekomandimet – dimensionet për kryerjen e punëve të caktuara si dhe është bërë kërkesë e përsëritur për pagimin e borxhit të cilin ua kishte firma “B.AG.” të dëmtuarve.

5.Gjendja faktike e vërtetuar dhe vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se biznesi “B.AG.” me bashkëpronar S.B. ka pasur raport ekonomik me kompaninë SH.P.K. “M.L.” me pronar I.L., NPT. “L.G.” me pronar R.H. dhe NPT “B..M.” me pronar F.B., fillimisht raporti ka qenë i mirë mirëpo ndërkohë biznesi “B.AG.” nuk i ka përmbushur detyrimet ndaj NPT. “L.G.” me pronar R.H. dhe NPT “B..M.” me pronar F.B. me arsyetimin se ka vështirësi financiare dhe nuk mund tua përmbush obligimin mirëpo ka qenë i kënaqur me cilësinë e materialeve dhe bashkëpunimin me këto biznese ndërsa i dëmtuari SH.P.K. “M.L.” me pronar I.L. dhe i pandehuri kanë pasur mosmarrëveshje sa i përket raportit të tyre ekonomik – juridik ku biznesi “B.AG.” është ankuar në cilësinë e materialeve të pranuar nga Sh.P.K. “M.L.”, kurse pala e dëmtuar i ka mohuar këto ankesa në cilësi duke theksuar se materialet kanë qenë në rregull kurse i pandehuri nuk ia ka paguar detyrimet të dëmtuarit pikërisht duke u thirrur në pretendimet e lartcekura. Gjatë zhvillimit të procedurës penale i pandehuri ia ka paguar në tërësi detyrimet palës së dëmtuar NPT “B..M.” me pronar F.B. si dhe është zotuar se do ia paguaj në tërësi detyrimet edhe palës së dëmtuar NPT. “L.G.” me pronar R.H..

Neni 335 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“Përveç siç parashihet në nenin 336 të këtij Kodi, kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”,* kurse paragrafi 5 i po këtij neni përcakton se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëm që tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet”.* Me paraqitjen e rrejshme të fakteve nënkuptohet pohimi për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo që vërtet ekziston, ajo që ekziston tregohet jo saktësisht. Fshehja e fakteve ekziston kur kryerësi, ndonjë person, e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t’i tregonte. Nga kjo rezulton se mashtrimi mund të kryhet edhe me mosveprim. Ndërkaq, te tregimi i rrejshëm, kryerësi e bind ndonjë person për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, d.m.th. te fshehja ai pengon personin që t’i mësojë faktet që vërtet ekzistojnë e të cilat janë relevante për pasjen në dispozicion të pasurisë së tij dhe pasurisë së huaj dhe të cilat do ta zmbropsin nga pasojat e dëmshme në raport me këtë pasuri. Andaj, duke u bazuar në të gjitha provat e administruara e veçanërisht pas dëgjimin të palëve të dëmtuara në shqyrtim gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari me anë të paraqitjes së rreme ka paraqitur ndonjë fakt apo ka fshehur faktet me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër. Ndërsa, vetëm mos përmbushja e obligimeve – borxhit nuk përbën vepër penale por mund të procedohet në procedurë kontestimore, pasi që edhe procesi gjyqësor në këtë çështje penale në dukje më shumë i ka ngjasuar një kontesti civil ku pala e pandehur pretendonte se Sh.P.K. “M.L.” nuk ia ka dërguar materialet sipas cilësisë së kërkuar – i ka dërguar materiale jo cilësore, kurse pala e dëmtuar ka pretenduar se materialet kanë qenë cilësore dhe i pandehuri nuk ia ka përmbushur detyrimet dhe atë në vlerë prej 59,782.09 euro.

Neni 20 i KPRK-së përcakton se: *“Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore”.* Në këtë çështje penalo-juridike nuk është arritur të provohet përtej dyshimit të bazuar mirë se me cilat veprime nga ana e të pandehurit është shkaktuar vepra penale e Mashtrimit ndaj palëve të dëmtuara. Gjithashtu, neni 3 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme*

për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozitë të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës". Gjykata nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor kur ka mëdyshje lidhur me faktet kryesore, në këtë çështje penale Prokuroria, nuk ka ofruar prova me të cilat do të vërtetohet se i pandehuri ka ndërmarrë ndonjë veprim apo ka fshehur ndonjë fakt për ti mashtruar të dëmtuarit.

Gjithashtu edhe në përshkrimin faktik të veprës penale të përshkruar në aktakuzë thuhet ndër të tjera "*...me anë të paraqitjes së rreme si pronarë të kompanisë për përpunimin e metalit "B.AG.", me seli në Cyrih – Zvicër, e cila nuk ekziston që nga viti 19.12.2012, kanë sjellë në lajthim tani të dëmtuarit...*", kurse nga Shkresa me 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe të formatit A4 nga Departamenti Federal për Ekonomi, Arsim dhe kërkim WBF i Sekretariatit për Çështje Ekonomike në Konfederatën Zvicerane gjykata gjeti se "B.AG." e ka deklaruar falimentimin me datë 25.05.2016 dhe ka falimentuar me datë 19.12.2017 dhe se S.B. ka qenë anëtar i bordit të "B.AG.", andaj duke marrë parasysh se vepra penale në aktakuzë pretendohet se ka ndodhur gjatë vitit 2014, kur edhe ka qenë aktiv biznesi "B.AG." me të drejtë shtrohet pyetja se cilin fakt të rremë e ka paraqitur apo e ka fshehur i pandehuri?

Po ashtu, kualifikimi ligjor në aktakuzë është në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa përveç të pandehurit në përshkrim faktik të veprës penale përmenden edhe Zh.B. dhe B.B., kurse nuk janë përcaktuar veprimet konkrete të cilat i ka ndërmarrë secili i pandehur veç e veç, në rastin konkret i pandehuri S.B., e gjithë kjo duke pasur parasysh se i dëmtuari R.H. ka deklaruar se nuk ndihet i mashtruar nga S.B. e po ashtu edhe pretendimit e të dëmtuarve I.L. dhe F.B. kanë qenë në drejtim të Zh.B. dhe B.B. ndërsa sa i përket të pandehurit S.B. vetëm sa i përket mos përmbushjes së obligimeve ku edhe ndaj të dëmtuarit F.B. e ka përmbushur në tërësi obligimin. Barra e provave i takon prokurorit të shtetit, ai ka për detyrë që me rastin e akuzimit të një personi, t'i parashtrijë gjykatës edhe provat me të cilat vërtetohet fajësia e tij. I pandehuri, përveç në rastin kur ligji shprehimisht e kërkon këtë prej tij, nuk është i detyruar të paraqesë prova me anën e të cilave do të provonte pafajësinë e vet. Qëndrimi eventual i kundërt, sipas të cilit i pandehuri do të ishte i detyruar të provojë se është i pafajshëm, e jo prokurori i shtetit, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Kodin e Procedurës Penale. Ana tjetër e manifestimit të prezumimit të pafajësisë konsiston në faktin që, po qe se në

procedurën penale nuk arrihet të provohet fajësia, gjykata duhet ta lirojë të akuzuarin nga akuza.

Meqenëse nuk është vërtetuar se i akuzuari S.B. e ka kryer veprën penale në bashkëkryerje Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjykata të njëjtin e liroi nga akuzua në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

6. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 459 paragrafi 4 i KPP-së përcakton se: “*Kur personi i autorizuar nuk e ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale para ngritjes së aktakuzës, ai duhet njoftuar se propozimin mund ta paraqesë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Kur me vepër penale është shkaktuar dëm në pasurinë në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore dhe nuk është paraqitur propozim, gjykata për këtë e njofton organin ose personin kompetent sipas nenit 458, paragrafi 2 i këtij Kodi. Pala informohet se mosparaqitja e propozimit mund ta përjashtojë palën e dëmtuar nga Programi i Kompensimit të Viktimave edhe nëse pala do të plotësonte kriteret tjera të pranueshmërisë sipas ligjit në fuqi*”. Andaj, gjykata e ka njoftuar palën e dëmtuar për këtë të drejtë, mirëpo i dëmtuari F.B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Neni 462 paragrafi 3 i KPP-së përcakton se: “*Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente*”. Andaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore sa i përket të dëmtuarit I.L. dhe R.H. vendosi që të njëjtit ti udhëzoj në kontest të rregullt juridiko –civil.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Neni 452 paragrafi 1 i KPP-së përcakton se: “*Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjyrimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetët buxhetore, përveç në*

rastët e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni". Andaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore vendosi që shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2020:115438, me datë 12.04.2024

Bashkëpunëtori Profesional,
Shkelzen Polloviqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.